



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKT V E N D I M

Nr. _____, datë _____.____, 2024

PËR
MIRATIMIN E STANDARTEVE PËR ZONAT DHE PARCELAT E TOKËS NË TË
CILAT DO TË LEJOHET KULTIVIMI I BIMËS SË *CANNABIS*-IT PËR QËLLIME
MJEKËSORE DHE INDUSTRIALE

Në mbështetje të neneve 100 të Kushtetutës, të shkronjës "c", të pikës 2. të nenit 9, të Ligjit Nr. 61/2023 "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *Cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale", me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

I. PËRKUFIZIMET

Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) "**Standardet**" janë tërësia e kërkesave dhe kriterëve që duhet të kenë zonat dhe parcelat e tokës për kultivimin e *Cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe industriale;
- b) "Parcelë e tokës" është sipërfaqe e kufizuar e tokës, përfituar me aktin e fitimit të pronësisë e cila do të përdoret për kultivimin e bimës së *cannabis*-it për qëllim mjekësor ose industrial në zbatim të përcaktimeve të ligjit 61/2023 "Për kontrollin e kultivimit dhe përpunimit të bimës së *Cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale",
- c) "**Ambient i mbrojtur**" është një mjedis i kultivues dhe i mbuluar, i cili krijon kushte të favorshme për rritjen e bimëve, duke mbrojtur ato nga ndikimet atmosferike të jashtme, si ndryshimet ekstreme të temperaturës, era apo reshjet e shiut. Ky ambient lejon depërtimin e rrezatimit diellor dhe zakonisht përfshin struktura si sera ose tunele plastike, që ofrojnë një shkallë të caktuar kontrolli mbi temperaturën, lagështinë dhe dritën, në përputhje me udhëzimet dhe Praktikat e Mira të Bujqësisë dhe të Mbledhjes (GACP) të Agjencisë Evropiane të Barnave.
- ç) "**Ambient i mbyllur**" është një mjedis plotësisht i kultivues, i mbuluar dhe izoluar nga ndikimet e jashtme atmosferike, i cili ofron kushte të favorshme për rritjen e bimëve pa depërtimin e rrezatimit natyror diellor. Ky lloj ambienti përdor ndriçim artificial dhe sisteme të kultivuesës për parametrat si drita, lagështia, temperatura, ventilimi dhe për ndikimin e faktorëve të tjerë të jashtëm, duke siguruar kushte optimale për kultivimin,

në përputhje me udhëzimet dhe Praktikat e Mira të Bujqësisë dhe të Mbledhjes (GACP) të Agjencisë Evropiane të Barnave.

- d) “Zonë” është tërësia e parcelave të tokës ku kultivohet bima e Cannabis-it për qëllim mjekësor ose industrial.
- dh) “Terren kultivues ose substrakt kultivues” është një material ose përzierje materialesh, natyrore ose të prodhuara, që siguron mbështetje fizike dhe furnizim me ushqyes për rritjen e bimëve, që mund të përfshijë tokë natyrale, torfë, perlit, vermikulit, fibra kokosi, apo substrakte të tjera që krijojnë kushte të përshtatshme për rritjen e bimëve në një ambient të kultivues, duke lejuar rregullimin e lagështisë, ajrimit dhe ushqyesve.

II. STANDARDET PËR ZONAT DHE PARCELAT E TOKËS PËR KULTIVIMIN E BIMËS SË *CANNABIS*-IT PËR QËLLIM MJEKËSOR DHE INDUSTRIAL.

1. Standardet për zonat dhe parcelat e tokës për kultivimin e bimës së *cannabis*-it për qëllim mjekësor janë:

- a) Parcelat e tokës, pjesë e njësisë së prodhimit, nuk mund të shtrihen brenda kufirit të zonave:
- të mbrojtura dhe me përparësi zhvillimin e turizmit të përcaktuara si të tilla me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe/ose të autoriteteve të planifikimit të territorit,
 - të pyjeve, kullotave dhe livadheve,
 - të sigurisë kombëtare ose ushtarake,
 - të përcaktuara si sistem urban në dokumentat e planifikimit vendor të territorit.
- b) Parcelat e tokës, pjesë e njësisë së prodhimit, duhet të jenë në largësi prej të paktën 3 km, në rrugë ajrore nga parqet e bletëve të miratuara sipas legjislacionit për bletarinë.
- c) Përqëndrimi i metaleve të rënda në tokë apo terrene kultivuese (substrakte kultivuese), ku kultivohet *Cannabis*-i për qëllime mjekësore, nuk duhet të kalojë vlerat maksimale të përcaktuara në shtojcën 1, bashkëlidhur këtij vendimi dhe pjesë përbërëse e tij.
- ç) Toka apo terrene kultivuese (substrakte kultivuese), ku kultivohet *Cannabis*-i mjekësor duhet të plotësojnë standardet e parashikuara në udhëzuesit për Praktikat e Mira Bujqësore dhe Grumbullimin të Agjencisë Evropiane të Barnave dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë, si dhe standardet e parashikuara nga Organizata Ndërkombëtare për Standardizim (ISO).

2. Standardet për zonat dhe parcelat e tokës për kultivimin e bimës së *cannabis*-it për qëllim industrial, janë:

- a) Parcelat e tokës, pjesë e njësisë së prodhimit, nuk mund të shtrihen brenda kufirit të zonave :
- të mbrojtura dhe me përparësi zhvillimin e turizmit të përcaktuara si të tilla me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe/ose të autoriteteve të planifikimit të territorit,
 - të pyjeve, kullotave dhe livadheve,
 - të sigurisë kombëtare ose ushtarake,
 - të përcaktuara si sistem urban nga dokumentat e planifikimit vendor të territorit.
- b) Parcelat e tokës, pjesë e njësisë së prodhimit, duhet të jenë në largësi prej të paktën 3 km në rrugë ajrore nga parqet e bletëve të miratuara sipas legjislacionit për bletarinë.

3. Në rastet kur për ushtrimin e aktivitetit parashikon kryerjen e ndërhyrjeve ndërtimore në parcelën e tokës pjesë e njësisë së prodhimit, ndërtimi kryhet sipas përcaktimeve të legjislacionit të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

4. Në rastet kur parcela e tokës përdoret është pjesë e sipërfaqes së tokës që përdoret për kultivimin e *Cannabis-it* për qëllime mjekësore ajo duhet të jetë e pajisur me aktin e fitimit të pronësisë në zbatim të përcaktimeve të Kodit Civil dhe ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”.

III. DISPOZITAT E FUNDIT

1. Standardet e parashikuara në nënndarjet “i”, “ii”, “iii” të germës “a” të pikën 1, të germës “b” të pikës 1 dhe të germës “b” të pikës 2 të Kreut II, nuk aplikohen kur kultivimi kryhet në ambiente të mbyllura.

2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis-it*, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E M I N I S T R I

ED I R A M A

SHTOJCA I

Vlerat maksimale për përqëndrimin e elementeve në terrenet kultivuese ose substraktet kultivuese

(në mg/kg lëndë e thatë, në një mostër përfaqësuese të tokave)

Metali dhe simboli kimik	Vlera maksimale (në mg/kg)
Antimoni (Sb)	2
Arsenik (As)	5
Merkur (Hg)	0.5
Kadmium (Cd)	1
Kobalt (Co)	20
Krom (Cr)	100
Baker (Cu)	100
Plumb (Pb)	60
Nikel (Ni)	50
Zink (Zn)	200
Vanadium (V)	100